



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 40, datë 03.12.2020

**PËR**  
**DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**  
**NR.23, DATË 28.02.2020 “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE QË DO TË**  
**NDIQEN PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMEVE, BRENDA ZONËS SË BREZIT**  
**BREGDETAR”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar; si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Në vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.23, datë 28.02.2020 “Për përcaktimin e procedurave që do të ndiqen për shqyrtimin e aplikimeve, brenda zonës së brezit bregdetar”, bëhen shtesat si më poshtë vijon:
  - a) në pikën 1, pas togfjalëshit “...ndryshim të subjekteve zhvilluese...” shtohet togfjalëshi “... dhe ndryshim i aktiviteteve/ funksioneve”.
  - b) në pikën 1, pas germës “d” shtohen germet “e” dhe “f” me përmbajtje si vijon:
    - e) rrjetet e fibrave optike;
    - f) muret rrethuese.”
  - c) pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me përmbajtje si më poshtë:

“3/1 Kërkesat për kryerjen e punimeve mbi bazën e një “deklarate paraprake për kryerjen e punimeve”, do të paraqiten dhe shqyrtohen pranë autoriteteve vendore të zhvillimit të territorit, me përjashtim të kërkesave për stacione plazhi, të cilat janë objekt i nje leje ndërtimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit.”

2. Ngarkohen Agjencia e Zhvillimit të Territorit për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi nga autoritetet përgjegjëse, si dhe të gjitha autoritetet e zhvillimit në nivel vendor, për ndjekien dhe zbatimin e tij.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

